



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 387/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.06.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Power Industries” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “Procedurë e hapur”, me objekt “Blerje karboni aktiv, për UKT sha”, me nr. REF-43122-01-31-2018, me fond limit 69,000,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 12.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomik “2AT” sh.p.k. dhe “Trimed” sh.p.k., në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Power Industries” sh.p.k.
Adresa: Blv. “Gjergj Fishta”, Qendra Alpas, Shk.2, Kati 5, Ap.14, Tiranë.

Autoriteti kontraktor:

Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a.
Adresa: Rr. “5 Maj”, pranë Medresesë, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184,

datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 02.02.2018, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “Procedurë e hapur”, me objekt “Blerje karboni aktiv, për UKT sha”, me nr. REF-43122-01-31-2018, me fond limit 69,000,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 12.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetës Kanalizime Tiranë sh.a.

II.2 Në datën 12.03.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 30.03.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. "2AT" sh.p.k.	40,750,000 lekë pa tvsh Kualifikuar;
2. "T&M Chemical Distribuion" sh.p.k.	42,250,000 lekë pa tvsh Skualifikuar;
3. "2-MJ" sh.p.k.	42,500,000 lekë pa tvsh Skualifikuar;
4. "Trimed" sh.p.k.	59,853,000 lekë pa tvsh Kualifikuar;
5. "Atlantik 3" sh.p.k.	62,500,000 lekë pa tvsh Skualifikuar;
6. "Power Industries" sh.p.k.	64,750,000 lekë pa tvsh Skualifikuar;

II.4.Nga verifikimet e kryera, rezulton se operatori ekonomik "Poëer Industries" sh.p.k. është njoftuar nëpërmjet Sistemit e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit, për arsytet si më poshtë vijon:

"Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik "POWER INDUSTRIES" sh.p.k me vlerë të ofertës 64.750.000(gjashtëdhjetë e katër milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë)lekë pa tvsh. • Së pari Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit kapaciteti teknik/ në pikën 2.3.2 si më poshtë cituar: Një punësim mesatar i të paktën 10(dhjetë) personave, për periudhën Qershor 2017 - Dhjetor 2017 të vërtetuar me; List pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Qershor 2017 - Dhjetor 2017 shoqëruar me formularet e deklaramit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga verifikimi i dokumentave të operatorit ekonomik në sistemin elektronik të app-së konstatoi se shoqëria "POWER INDUSTRIES" shpk ka paraqitur në përmbushje të këtij kriteri listëpagesat për periudhën Qershor 2017 –Dhjetor 2017 por nuk ka arritur të paraqesë formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se dokumentacioni i shoqërisë lidhur me kriterin e mësipërm është i paplotë për rrjedhojë i pasaktë. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik",I ndryshuar e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit"

II.4.Në datën 05.04.2018 operatori ekonomik ankimues "Power Industries" sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, si dhe kundërshton kualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomik "2AT" sh.p.k. dhe "Trimed" sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.5. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 10514/1 Prot. datë 06.04.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues "Poëer Industries" sh.p.k., duke mos e pranuar ankesën e tij.

II.6.Në datën 12.04.2018 operatori ekonomik ankimues "Power Industries" sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur në autoritetin kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi duke argumentuar si më poshtë vijon:

"[...]Ne date 05.04.2018 kemi derguar ankesen prane autoritetit kontraktor me nr. 10514 prot duke kundërshtuar vendimin e AK per skualifikimin e padrejte te shoqerise sone dhe njeanshmerine e AK per kualifikimin e OE 2AT dhe TRIMED shpk . Po ne date 05.04.2018, pa kaluar as dy ore nga depozitimi i ankeses AK na kthen pergjigje ne adresen tone te e-mailit per vendimin e tyre duke mos pranuar ankesen tone ,vendim qe mban nr10514/1 prot i cili ka ardh edhe me poste me date 06.04.2018. Sa me siper i drejtohem Komisionit te Prokurimit Publik (KPP) si organ specifik, quasigjyqësor, me juridiksionin për të siguruar mbrojtje ligjore në prokurimin publik per te konstatuar dhe rregulluar shkeljet e bera nga AK gjate vleresimit te kesaj procedure prokurimi. Analize dhe argumentime: Ne lidhje me këtë procedure i parqitem AK kontestimet tona ne lidhje me aftësitë teknike te subjekteve te kualifikuara nga ana e AK dhe përputhshmërinë e dokumentacionit te tyre tekniko administrative me kërkesat e DT te kërkuara nga AK si dhe mungesën e lidhjes shkakësore dhe rrjedhimisht te ligjshmërisë se vendimit tuaj per kualifikimin e ofertës tone. I. Përsa i përket skualifikimit tone te padrejte: Ne kriteret e veçanta për kualifikim, seksioni 2.3.2 te DT është kërkuar: "Një punësim mesatar i te paktën 10 personave, për periudhën qershor 2017 dhjetor 2017, te vërtetuar me: Vërtetim të lëshuar nga sigurimet shoqërorë ose administrata tatimore, ku te specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Qershor 2017- Dhjetor 2017. Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni ne fuqi për periudhën Qershor 2017 - Dhjetor 2017 shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore shëndetësore." Në plotësim të kësaj kërkesë ne kemi dorëzuar/ngarkuar ne sistemin e prokurimit elektronik vërtetimin Nr.436 Prot. date 24.01.2018 te DTT qe vërteton numrin e punonjësve për secilin muaj te kërkuar nga ana juaj;

Vërtetimin me Nr.T00151857 Date 27.02.2018 Per pagimin e Detyrimeve te marre nga sistemi E-albania dhe vertetimin me nr 434 prot date 24.01.2018 te leshuar nga DPT ,ku theksohet fakti qe shoqeria jone nuk ka asnjelloj detyrimi apo gjobe te papaguar (perfshire detyrimet kontributet per Sigurimet Shoqerore dhe Shendetesore). Liste pagesën e punonjësve sipas formatit te kërkuar nga Ministria e Financave me udhëzimin e saj nr. 23, dt. 9.12.2014. Pra ne tërësi dhe ne fryme ne kemi plotësuar kërkesën e AK për te dëshmuar se ne si konkurrent ne këtë procedure prokurimi kemi aftësitë teknike dhe kapacitetet për te realizuar kontratën. Dokumentet e dorëzuara nga ana jone plotësojnë kërkesën tuaj specifike për punësimin mesatar te 10 personave, si dhe dokumentacionin mbështetës për te qe janë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore dhe listë pagesat sipas formatit te kërkuar nga legjislacioni ne fuqi. Ne lidhje me argumentin tuaj se ne nuk kemi dorëzuar formularët e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ju bëjmë me dije se ky formular nuk është me një kërkesë e detyrueshme. Udhëzimi Nr. 23, datë 9.12.2014 i Ministrisë se Financave me digjitalizimin e sistemit tatimor ka ndryshuar proceset dhe llojin e dokumenteve te detyrueshme për dorëzimin e Liste pagesave dhe FDP

si dhe marrjes së vërtetimeve administrative qofte në E-tatime apo në e-albania. Thënë shkurt FDP e kërkuar nga ana juaj në sistem gjenerohet si një informacion personal me të cilën nuk mund të bëhen veprime as në banke, e jo me në AK (bashkangjitur një shembull i FDP-se që gjenerohet nga sistemi përpara hyrjes në fuqi udhëzimit Nr 23/2014). Duke dashur t'ju sjellim në epokën e digjitalizimit, ju sqarojmë se kjo kërkesë është shumë e vjetër dhe është bazuar në praktikën e AK të cilat për bazoheshin në sisteme manuale të këqyrjes dhe kontrollit të informacionit dhe në ato të të Udhëzimit të kohës nr. 26, dt. 16.4.2009, Kreu III. Tani në këtë epokë të re të informatizimit të sistemeve tatimore ky dokument nëse e quajmë të tillë nuk konsiderohet me dokument zyrtar nga vete organi që e gjeneron atë pra MF. Pra sistemet e integruara të informacionit të implementuara nga MF dhe DPTT gjenerojnë njoftimin se “Kjo kopje e deklaratës nuk mund të përdoret për të kryer pagesa në banke. Kjo kopje mund të përdoret për nevojat tuaja personale....” dhe për të kryer pagesën gjenerohet fletë pagesë që nuk ka lidhje me këtë formular dhe nuk është as dokument ekuivalent apo zëvendësues i tij. Prandaj nuk ka sens të kërkojë atë që nuk ekziston. Neni 27 i VKM nr. 914, datë 29.12.2014 parashikon se “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës..” ndërsa neni 46 i LPP-se parashikon se: Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese: a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata; b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilanci, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe ,në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit të financiare, kur ky informacion është i mundur; Udhëzimi Nr. 23, datë 9.12.2014 nuk ka asnjë kërkesë specifike për këtë FDP, e cila ka qene në udhëzimet e kaluara, por që në vitin 2014 e në vijim ky dokument shërben thjesht si një informacion personal që gjenerohet nga sistemi bazuar në praktikën e kaluara, dhe nuk është kusht për të konfirmuar plotësimin e detyrimeve nga tatimpaguesi për punonjësit dhe derdhjen e kontributeve të tyre. Pra e thënë troç ky “dokument” që kërkohet nga ana juaj në të vërtetë është informacion personal por që nuk është dokument zyrtar. Dhe si i tillë nuk dëshmon asgjë. Pra nuk dëshmon as kryerjen e pagesës as moskryerjen e saj. Vete sistemi e-tatime

bazuar ne këtë udhëzim njeh vetëm listë pagesat dhe përpara lëshimit te vërtetimit e-sig, verifikon dhe kontrollon plotësimin e detyrimeve nga ana e tatimpaguesit, ne këtë rast kompaninë tone, për punonjësit e deklaruar. Madje edhe vete përmbajtja dëshmon se ky informacion ndodhet ne administratën tatimore dhe është subjekt verifikimi/ kontrolli përpara gjenerimit te vërtetimit te kërkuar nga ana juaj. Udhëzimi ka përcaktuar qarte se dokument tatimor është vërtetimi e-sig dhe listë pagesa e kontributeve (ajo e dorëzuar nga ana jone). Pika 4 dhe 5 e këtij udhëzimi parashikon detyrimin qe te dhënat te hidhen elektronikisht...” 5.1 Deklarimi i të dhënave për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga të gjithë tatimpaguesit persona juridikë dhe fizikë, nga periudha tatimore dhjetor 2014 e në vazhdim, bëhet vetëm në formë elektronike sipas përmbajtjes së rubrikave të dokumenteve “Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi” dhe “Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna”. Vetëm për tatimpaguesit subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, deklarimi për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore bëhet vetëm në formë elektronike sipas përmbajtjes së rubrikave të dokumenteve “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” dhe “Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna”, nga periudha tatimore tetor 2014 e në vazhdim. Në kuptimin e nenit 10 të ligjit nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve te detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të këtij udhëzimi, deklaratat “Listë pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” dhe “Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi si dhe e të larguarve nga puna” janë deklarata tatimore sipas përcaktimit në nenin 64 të ligjit nr. 9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Reoublikën e Shqipërisë” të ndryshuar. Deklarata “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” është njëkohësisht deklarim i detyrimeve të tatimpaguesit për kontributet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe për tatimin mbi të ardhurat nga punësimi...”. Pra referuar edhe kërkesës tuaj ne DT se “Listë pagesat e punonjësve sipas formatit qe kërkohet nga legjislacioni ne fuqi për periudhën qershor 2017 dhjetor 2017 shoqëruar me formularët e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore shëndetësore.”, referuar këtij legjislacioni ne fuqi fjalia e fundit nuk është me dokument si dikur dhe si i tille nuk dëshmon se ne si tatimpagues nuk kemi plotësuar detyrimet për derdhjen e kontributeve ne administratën tatimore. Tërësia e informacionit e dorëzuar nga ana jone dëshmojnë si e zeza mbi te bardhe se ne kemi tejkualuar numrin e punonjësve te kërkuar ne DT, dhe nuk kemi asnjë detyrim për pagesën e kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Informacioni arkaik qe është reminishence e se shkuarës se stafit tuaj nuk mund dhe nuk përbën asnjë mangësi. Tërësia e dokumenteve tone plotësojnë kushtin për te verifikuar numrin e punonjësve te kërkuar nga ana juaj, vërtetojnë se i kemi plotësuar te gjitha detyrimet ndaj tyre dhe procedurat e vendosura nga MF për lëshimin e vërtetimeve ka tejkualuar ngërçin e informalitetit duke dëshmuar se dokumenti shoqërues i kërkuar nuk vlen me si i tille madje as për pagese ne Banke por si një informacion personal. Dhe si i tille mungesa e këtij informacioni për AK

bazuar ne legjislacionin referues te mësipërm nuk ka asnjë pasoje dhe asnjë rezultat (mungon lidhja shkakësore) për AK, per MF dhe për vete ne si OE. Kemi kerkuar nga AK te vleresoj te ligjshme dhe te kualifikuar ofertën tone, duke qene se vete thelbi i LPP-se nuk është leximi binarik i kriterëve por leximi teologjik i tij për te përcaktuar (Ex Post) nëse subjekti i ka kapacitetet teknike, ekonomik, ligjore për te realizuar kontratën ose jo. Dhe ne këtë rast ky informacion nuk dëshmon asgjë dhe nuk ndryshon apo devijon asnjë kriter nga ato te kërkuar duke qene se formulimi i kerkeses nga vet AK ka qene i gabuar ndaj AK duhet te mbaj parasysh faktin qe konfuzioni ka ardhur si pasoje e paqartësisë se tij ne perpilimin e kerkeseve ndaj kjo nuk mund dhe nuk duhet te ndikojne ne vleresimin e padrejte dhe te pabarabarte midis OE sipas interesave te AK. Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave pavaresisht shpjegimeve dhe arsytetimeve tona mesa duket eshte mjaftuar me nje konsultim me anetaret e KVO (nisur edhe nga koha e shqyrtimit te ankeses dhe kthimit te pergjigjes) dhe nuk ka kuptuar,logjikuar dhe konstatuar ate cfare ne kemi kerkuar dhe theksuar ne argumentat tona por eshte mjaftuar me nje " Operatori ekonomik ka kontestuar ne ankesen paraqitur prane Autoritetit Kontraktor arsyen e skualifikimit per te cilat pranon ne ankesen depozituar prej tij që nuk e ka paraqitur si dokumentacion por e konsideron por kerkon qe te konsiderohen nga autoriteti kontraktor si devijime te vogla Pra referuar ligjit dhe akteve nënligjore ne fuqi Ju si operator ekonomik duhet te paraqisni! formularët e deklarimit të pagesave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në formen e sakte referuar dokumentave standarte te tenderit dhe akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi. ". Ne asnje moment shoqeria jone nuk e pranon qe ka devijuar nga kerkesat e AK por kemi theksuar dhe shpjeguar qe "AUTORITETI KONTRAKTOR KA KERKUAR NJE DOKUMENT QE NUK EKZISTON " dhe shoqeria jone nuk ka si te paraqes dicka qe nuk eshte me , pasi eshte hequr nga Ministria e Financave me Udhëzimin Nr. 23, datë 9.12.2014 . Formulimi i kerkeses nga ana e autoritetit kontraktor eshte i gabuar kete mund ta konstatoj cdo ekonomist apo specialist i fushes qe dokumenti i kerkuar nga AK nuk gjenerohet me nga sistemet tatimore por AK me sa duket nuk do ose nuk i intereson ta kuptoj dhe vazhdon te kerkoj paraqitjen e ketij dokumenti (bashkangjitur po ju dergojme nje shembull te dokumentit qe kerkohet nga AK por qe Shoqeria nuk ka se ku ta marr nje dokument te tille). Ne si OE kemi paraqitur cdo dokument te mundshem per plotesimin e nevojës se AK per tu njohur si me fuqine punetore ashtu edhe me shlyerjen e te gjitha detyrimeve tatimore ,sigurimeve shoqerore e shendetesore. Ndoshta AK ka dashur te kerkoj me ane te kesaj pike urdhr pagesat per shlyerjen e detyrimeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore apo dicka tjeter ,por ne nuk mund te hamendesojme dhe te zbulojme se cfare kerkon AK te shpreh me ane te nje kerkese qe nuk eshte e qarte dhe si ne rastin tone ka cuar ne skualifikimin e shoqerise dhe nje vleresim te pabarabarte midis pjesmarresve ne kete procedure. Duam te theksojme nenin 23 pika 1 dhe 2 te LPP " Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara. 2. Specifikimet teknike duhet të

mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik." ne kete rast kjo paqartesi ka ndodhur me kerkesat per kualifikim por vlen i njeiti parim pasi shoqeria jone eshte prekur, demtuar, diskriminuar duke u skualifikuar padrejtesisht nga AK nisur nga konfuzioni dhe gabimi qe AK ka kryer ne hartimin e kerkesave per kualifikim . Kerkojme nga autoriteti juaj kualifikimin e shoqerise sone pasi nuk mund te penalizohemi per gabimet qe AK ka bere gjate hartimit te dokumentave te tenderit duke formualuar kerkesat gabim ndoshta me mendimin per te krijuar konfuzion si ne kete rast dhe skualifikuar nje shoqeri e cila ka deshmuar qe i ploteson te gjitha kapacitetet dhe kriteret e nevojshme dhe te domosdoshme per realizimin me sukses te kontrates .

Se Dyti ne ankesen drejtuar AK kemi shprehur kontestimet tona mbi kualifikimin e padrejte te subjekteve konkurruese të cilat supozohen të ofrojnë siguri për pastërtinë e ujit të pijshëm të rreth gjysmë popullatës së Republikës së Shqipërisë si me poshte :

a. Oferta e OE 2AT me vlere 40,750,000 leke pa TVSH;

1. Nuk ka paraqitur Test Raporte (flet analiza te produktit) me analizimin/testimin e te gjithë elementeve sipas kerkeses se AK, janë pranuar mallra pa test raporte, të paplota, tërësore dhe që nuk përputhen me raportin triangular cilësi, çmim, kohë dhe analiza me afate te tejkaluara.

2.Nuk ka parqitur test raport (Flete analize te produktit) nga laboratore te Akredituar me ISO 17025

3.Fusha e akreditimit te laboratorit sipas ISO 17025 duhet te perputhet me objektin e prokurimit qe te mundesoj analizimin e elementeve perberes te Karbonit Aktiv pluhur sipas kerkesave tuaja ne DST ,operatori ekonomik 2AT nuk e ka paraqitur .

4. Nuk është zhvilluar vlerësimi tërësor i mostrave të kërkuara ,nuk eshte kryer testimi apo analiza te posacme nga ana e AK per mostrat e paraqitura ne ditën e hapjes se ofertave . Kërkojmë kryerjen e verifikimeve për çdo mostër te dorëzuar përpos mostrës tone dhe ato te OE te kualifikuar ose jo nga AK me qellim trajtimin e barabarte te OE.

b. Oferta e OE TRIMED SHPK me vlerë 59,853,000 leke pa TVSH

1. Nuk ka paraqitur Test Raporte (flet analiza te produktit) me analizimin/testimin e te gjithë elementeve sipas kerkeses se AK , janë pranuar mallra pa test raporte, të paplota, tërësore dhe që nuk përputhen me raportin triangular cilësi, çmim, kohë dhe analiza me afate te tejkaluara.

2.Nuk ka parqitur test raport (Flete analize te produktit) nga laboratore te Akredituar me ISO 17025.

3.Fusha e akreditimit te laboratorit sipas ISO 17025 duhet te perputhet me objektine e prokurimit qe te mundesoj analizimin e elementeve perberes te Karbonit Aktiv pluhur sipas kerkesave tuaja ne DST ,operatori ekonomik 2AT nuk e ka paraqitur.

4. Nuk është zhvilluar vlerësimi tërësor i mostrave të kërkuara ,nuk eshte kryer testimi apo analiza te posacme nga ana e AK per mostrat e paraqitura ne ditën e hapjes se ofertave . Kërkojmë kryerjen e verifikimeve për çdo mostër te dorëzuar përpos mostrës tone dhe ato te OE te kualifikuar ose jo nga AK me qellim trajtimin e barabarte te OE

5. Objekti i prokurimit nuk përfshihet në fushën e veprimtarisë QKB së operatorit ekonomik TRIMED shpk .

6. Referuar fushës së veprimtarisë së BOE shoqërite nuk plotësojnë kërkesën për kontratë të ngjashme.

* Kërkesat e AK në DST seksioni 2.3.2 ka kërkuar ndër të tjera për OE pjesëmarrës që të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë test raportet për lëndën Karbon Aktiv ku të jenë testuar parametrat e përcaktuar sipas standardit S SH EN 12903:2009. Test raportet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të origjinalit të lëshuara nga laborator kombëtare të akredituara ose laborator ndërkombëtare të akredituara për të vërtetuar sa më sipër kërkohet të paraqitet: Certifikata e akreditimit të laboratorit 17025. Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit dhe Pika 2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra si më poshtë: 1. Karbon Aktiv 2. Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit. 3. Mosparaqitja e mostrave përbën kusht për skualifikim. 4. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të secilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, hedhjen në silloz neper adresat e autorizuar nga AK (tek specifikimet teknike). Ndërsa në shtojca 10 të Specifikimeve Teknike ndër të tjera janë përcaktuar se: Treguesit e cilësisë dhe të siurisë së karbonit aktiv pluhur që do të përdoret për trajtimin e ujit në Impiantin Bovillë duhet të përmbushin parametrat si më poshtë : Parametrat e mësipërm janë në përputhje me Standardin Shqiptar S SH EN 12903:2009 dhe S SH EN 12902:2004.

Për më tepër në këtë procedurë prokurimi në pikën 2.3.4 është kërkuar : Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi me objektin e prokurimit për mallin e kërkuar. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

1. Shoqëria 2AT shpk. Shoqëria jone si OE ofertues pretendon dhe ngre dyshimet mbi baza dhe studime konkrete që shoqëria 2AT nuk ka paraqitur test raporte të plota ku të jenë testuar të gjithë parametrat e kërkuar nga AK si dhe nga standardi Shqiptar. Pra karboni i ofertuar nuk mund të vërtetohet që i përmbush të gjithë parametrat dhe i ka ato në nivelet e kërkuara dhe brenda limiteve gjë që e cila rrezikon drejtpërdrejtë ndotjen e ujit të pijshëm pasi karboni përmban lende toksike dhe metale helmuese si Jone Cianur (CN'), Selenium (Se), Plumb (Pb), Nikel (Ni), Merkur (Hg), Krom (Cr), Kadmiumi (Cd), Arseniku (As), Zinku (Zn). Në si OE konkurrues në këtë procedurë akuzojmë AK se ka favorizuar subjektin 2AT pasi ai nuk ka paraqitur test raportet për zërat e kërkuar. Pra në tërësinë e këtyre zërave test raporti nuk i trajton fare ato. Parametrat e sipërpërmendur duhet të jenë patjetër brenda normave dhe limiteve të lejuara ashtu si paraqitet në tabelën e specifikimeve teknike si dhe në standardin shqiptar. Shoqëria 2AT nuk i ka testuar këto parametra në një laborator të akredituar me certifikatë ISO 17025 për testimin e këtyre lendeve dhe këtyre parametrave . E cila duhet të jetë e pasqyruar në fushën e akreditimit të laboratorit . Kujtojmë se cilësia e ujit të pijshëm të banoreve të Tiranës, është e një rëndësie jetike në nivel të sigurisë publike e

asaj kombëtare ndaj serioziteti për të Vlerësuar ofertat duhet të jete ne nivelet me të larta. Jemi të sigurt se konkurenti nuk ka kryer test raporte ne laborator të akredituar me standardin 17025. Këtë dyshim të arsyeshëm e bazojme ne faktin se ne republikën e Shqipërisë nuk ka asnjë laborator të akredituar i cili mund të analizoje dhe testoj të gjithë elementet e kërkuar nga AK ne DST, mbi të gjitha theksojmë faktin që edhe ne rast se i mbledhim të gjithë laboratorët e akredituar nga DPA sipas standartit 17025 (<http://dpa.gov.al/sq/organizma-te-akredituara>) nuk arrijne të testojne të gjithë elementet e kërkuar shkojmë me tej me bindjen se laboratorë të akredituar me këtë standard janë të pakte, dhe laboratorë të akredituar për të kryer testime për të gjitha zërat e kërkuar reduktohen edhe me shume. AK duhet të verifikojë nëse test raportet janë kryer për të gjithë elementet e kërkuara ne DST, pasi dyshojmë se OE të klasifikuar e kanë kryer test raportin për të gjithë elementet teknike. Kujtojmë se behet fjale për ujën e pijshëm të Tiranës, ku banojnë me shume se gjysma e popullatës së vendit. Pra KËRKOJMË nga AK që përveçse të verifikojë nëse shoqëria 2AT ka dorëzuar test raportet, a janë ato të plota (për të gjitha zërat), a janë ato të lëshuar nga një laborator i akredituar me standardin 17025, dhe nëse ky laborator i akredituar a është i akredituar për kryerjen e test raporteve dhe analizave për specifikimet për tërësinë e zërave të mësipërme, pra fusha e akreditimit ose programi? Këtë kërkesë po e sjellim si shembull me rastin e një Universiteti. Një Universitet jo publik para se të Filloj aktivitetin licencohet të ushtroje aktivitet në disa dege shkencore, dhe agjencia e akreditimit e akrediton atë vetëm për një dege nga tërësia e degëve për të cilën është licencuar. Dhe ne këtë rast diploma që njihet është ajo e akredituar si program që rrjedhimisht është dhe ne licence dhe jo nuk mund të ndodhe e kundërta pra që të njihet një diplomë e lëshuar nga një UP i licencuar për p.sh. stomatologji. Referuar Rekomandimeve me të fundit të APP-së dhe DPA-së, përplotësimin e këtij kushti ka një sere referencash që mund të gjinden online në faqet e autorizuara në organeve kompetente akredituese të njohura në RSH. P.Sh. Ne po sjellim në vëmendjen tuaj praktiken tone jo sepse ajo është me e mira por sepse ajo bazohet në praktike ligjore dhe administrative. Pra refemar parimit të kontradiktoritetit praktika është një dhe jo dy (<http://www.waterlabs.gr/contact.html>). Për sa i përket vlefshmërisë së test raportit duke marrë parasysh dhe specifikimet teknike të paraqitura në tender ku theksohet se “në momentin e furnizimit të lëndës Shoqëria furnizuese duhet të paraqesë test raporte të paktën çdo tre muaj“. Pra AK me anë të këtij kriteri prezumon se dhe test raportet e mostrës së ofertuar nuk mund të jene me të vjetra se 3 muaj pasi do i bënte ato të pavlefshme, pasi është një prezumim ex ante. Referuar edhe procedurës së vitit të kaluar ku operatore ekonomik janë skualifikuar me arsyetimin se nuk kanë shoqëruar Certifikatat personale Iso [...] me dokumentin e akreditimit, në rastin konkret edhe për shkak të rëndësisë së përdorimit të produktit të prokuruar pra trajtimit të ujit të pijshëm shoqëria 2AT duhet jo vetëm të paraqiste një test raport ku të përfshihen testimet e elementeve sipas kërkesës së AK , test raport i cili duhet jo vetëm të përmbaje të dhëna apo vule që nënkupton akreditimin por që duhet të shoqërohet edhe me dokumentet provues të laboratorit testues që ka kryer këto analiza në fushën e të cilit të përfshihet edhe objekti i prokurimit shkak të rëndësisë së test raportit ku analizohen të gjithë elementet kimik që janë të dëmshëm në trajtimin e ujit të pijshëm. Sipas rekomandimit nr. 3330 date

20.03.2018 APP dhe m. 145 prot date 16.03.2018 DPA i cili ka hyre ne fuqi me date 20.03.2018 ne lidhje me hartimin e kërkesave te cilësisë thekson rëndësinë qe ka akreditimi i dokumenteve/certifikatave te lëshuara nga organizmat e vlerësimit te konformitetit (laboratorë testues, kalibrues, organizëm certifikues i sistemeve te menaxhimit... etj.) te cilat janë te akredituara nga DPA ose nga organizma ndërkombëtar akreditues te njohur nga Republika e Shqipërisë. Si reference po ju dërgojmë praktiken online te akreditimit te laboratorit tone sipas udhëzimit te APP. (<http://www.waterlabs.gr/contact.html>). Nisur nga rëndësia e objektit te prokurimit dhe qëllimit te përdorimit te produktit te prokuruar Autoriteti kontraktor nuk mund te anashkaloj njëkërkesë te tille dhe duhet te ndjek te gjitha hapat për te marre informacion për verifikimin e vlefshmërisë dhe mbulimin e objektit te prokurimit ne fushën e testimit te laboratorëve përkatës. Përpos faktit qe test raportet duhet te jene lëshuar nga laboratorë te akredituar duhet qe akreditimi përkatës i tyre te jete i njohur edhe nga Republika e Shqipërisë ne baze te nenit 13, pika 3 e ligjit nr. 116/2014"Per akreditimin e organeve te vlerësimit te konformitetit ne Republikën e Shqipërisë "i ndryshuar . Mostrat e dorëzuara nga ana jone tek AK nuk i janë nënshtruar asnjë verifikimi te posaçëm e asnjë laborator vendas dhe jo me te huaj nga ana e AK dhe dyshimi i arsyeshëm dhe bindja ekziston qe as për këto subjekte te kualifikuara nuk është kryer ky verifikim. Kërkojmë kryerjen e verifikimeve për çdo mostër te dorëzuar përpos mostrës tone dhe ato te OE te kualifikuar ose jo nga AK me qellim trajtimin e barabarte te OE. Mostrat janë kërkuar nga AK për vlerësim dhe jo për mbajtje produkti vitrine pasi ne te kundërt kjo kërkesë kthehet ne boomerang për AK. AK per sa kohe ka kërkuar mostrën dhe test raportet nënkupton Ex Ante se këto informacione do te verifikohen pra verifikim dokumentar dhe fizik. Por për këtë te fundit duhet te kërkojë verifikime ne laboratorë te specializuara. Nëse do te ecim me logjiken e heshtur te AK, nëse një OE sjell test raporte për karbon dhe mostër ka sjelle klor, atëherë ai është i privilegjuar për te dorëzuar klor bazuar ne kërkesat e posaçme te kontratave te furnizimit te parashikuara ne KC. Pra ne këtë supozim OE ka përdorur rezervën ligjore, ndaj AK është i detyruar te verifikojë mostrën dhe jo ta mbaj aty ne zyrrat e tij për mall vitrinë. Për me tepër ne piken 2.3.4 është kërkuar : Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi me objektin e prokurimit për mallin e kërkuar. Ne rast se do të paraqitet Ajo e fundit duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Rrjedhimisht ne test raportin e paraqitur duhet te deklarohej origjina e lendes kimike dhe prodhuesi ne mënyrë qe te krijohet lidhja dhe te vërtetohet se produkti i ofertuar është i prodhuar nga kompania nga e cila është marre autorizimi dhe dokumentet e tjerë.

Pra OE ofertues nuk mund te testoje një produkt ne laboratorët shqiptare apo te huaj ne emër të shoqërisë se tij dhe ta paraqesë ne tender si produkt te një kompanie X prodhuese sepse nuk vërtetohet qe ajo mostër i përket atij prodhuesi.

2. Shoqëria TRIMED shpk. Shoqëria jone si OE ofertues pretendon dhe ngre dyshimet mbi baza dhe studime konkrete qe shoqëria TRIMED shpk nuk ka paraqitur test raporte te plota ku te jene testuar te gjithë parametrat e kërkuar nga AK si dhe nga standardi Shqiptar. Pra

karboni i ofertuar nuk mund te vërtetohet qe i përmbush te gjithë parametrat dhe i ka ato ne nivelet e kërkuara dhe brenda limiteve gjë qe e cila rrezikon drejtpërdrejtë ndotjen e ujit te pijshëm pasi karboni përmban lende toksike dhe metale helmuese si Jone Cianur (CN'), Selenium (Se), Plumb (Pb), Nikel (Ni), Mërkur (Hg), Krom (Cr), Kadmiumi (Cd), Arseniku (As), Zinku (Zn). Ne si OE konkurrues ne këtë procedure akuzojmë AK se ka favorizuar subjektin TRIMED shpk asi ai nuk ka paraitur test raportet për zërat e kërkuar: Pra ne tërësinë e këtyre zërave test raportit nuk i trajton fare ato. Parametrat e sipërpërmendur duhet te jene patjetër brenda normave dhe limiteve te lejuara ashtu si paraqitet ne tabelën e specifikimeve teknike si dhe ne standardin shqiptar. Shoqeria TRIMED shpk nuk i ka testuar këto parametra ne një laborator te akredituar me certifikate ISO 17025 për testimin e këtyre lendeve dhe këtyre parametrave . E cila duhet te jete e pasqyruar ne fushën e akreditimit te laboratorit. Kujtojmë se cilësia e ujit te pijshëm te banoreve te Tiranës, është e një rëndësie jetike ne nivel e sigurisë publike e asaj kombëtare ndaj serioziteti për te vlerësuar ofertat duhet te jete ne nivelet me te larta. Jemi te sigurt se konkurrenti nuk ka kryer test raporte ne laborator te akredituar me standardin 17025. Këtë dyshim te arsyeshëm e bazojmë ne faktin se ne republikën e Shqiperise nuk ka asnje laboratore te akredituar i cili mund te analizojë dhe testoj te gjithë elementet e kerkuar nga AK ne DST , mbi te gjitha theksojmë faktin qe edhe ne rast se i mbledhim te gjithë labororet e akredituar nga DPA sipas standartit 17025 (<http://dpa.gov.al/sq/organizma-te-akredituara>) nuk arrijne te testojne te gjithë elementet e kerkuar shkojme me tej me bindjen se laboratorë te akredituar me këtë standard jane te pakte, dhe laboratorë te akredituar për te kryer testime për te gjitha zërat e kërkuar reduktohen edhe me shume. AK duhet te verifikojë nëse test raportet janë kryer për te gjithë elementet e kërkuara ne DST, pasi dyshojmë se OE te klasifikuar e kane kryer test raportin për te gjithë elementet teknike. Kujtojmë se behet fjale për ujin e pijshëm te Tiranës, ku banojnë me shume se gjysma e popullatës se vendit. Pra KËRKOJMË nga AK qe përveçse te verifikojë nëse shoqeria TRIMED shpk ka dorëzuar test raportet, a janë ato te plota (për te gjitha zërat), a janë ato te lëshuar nga një laborator i akredituar me standardin 17025, dhe nëse ky laborator i akredituar a është i akredituar për kryerjen e test raporteve dhe analizave për speciflkimet/ për tërësinë e zërave te mësipërme, pra fusha e akreditim ose programi? Këtë kërkesë po e sjellim si shembull me rastin e një Universiteti. Një Universitet jo publik para se te filloj aktivitetin licencohet te ushtroje aktivitet ne disa dege shkencore, dhe agjencia e akreditimit e akrediton atë vetëm për një dege nga tërësia e degëve për te cilën është licencuar. Dhe ne këtë rast diploma qe njihet është ajo e akredituar si program qe rrjedhimisht është dhe ne licence dhe jo nuk mund te ndodhe e kundërta pra qe te njihet një diplome e lëshuar nga një UP i licencuar për p.sh. Stomatologji. Referuar Rekomandimeve me te fundit te APP-se dhe DPA-se, përplotësimin e këtij kushti ka një sere referencash qe mund të gjinden online ne faqet e autorizuara ne organeve kompetente akredituese te njohura ne RSH. P.Sh. Ne po sjellim ne vëmendjen tuaj praktiken tone jo sepse ajo është me e mira por sepse ajo bazohet ne praktike ligjore dhe administrative. Pra referuar parimit të kontradiktoritetit praktika është një dhe jo dy (<http://www.waterlabs.gr/contact.html>). Për sa i përket vlefshmërisë se test raportit duke marre parasysh dhe specifikimet teknike te paraqitura ne tender ku theksohet se “ne

momentin e furnizimit te lendes Shoqëria furnizuese duhet te paraqesë test raporte te paktën çdo tre muaj“. Pra AK me ane te këtij kriteri prezumon se dhe test raportet e mostrës se ofertuar nuk mund te jene me te vjetra se 3 muaj pasi do i bënte ato te pavlefshme, pasi është një prezumim ex ante. Referuar edhe procedurës se vitit te kaluar ku operatore ekonomik janë skualifikuar me arsyetimin se nuk kane shoqëruar Certifikatat personale Iso [...] me dokumentin e akreditimit, ne rastin konkret edhe për shkak te rëndësisë se përdorimit te produktit te prokuruar pra trajtimit te ujit te pijshëm shoqëria TRIMED shpk duhet jo vetëm te paraqiste një test raport ku te përfshihen testimet e elementeve sipas kërkesës se AK , test raport i cili duhet jo vetëm te përmbaje te dhëna apo vule qe nënkupton akreditimin por qe duhet te shoqërohet edhe me dokumentet provues te laboratorit testues qe ka kryer këto analiza ne fushën e te cilit te përfshihet edhe objekti i prokurimit shkak te rëndësisë se test raportit ku analizohen te gjithë elementet kimik qe janë te dëmshëm ne trajtimin e ujit te pijshëm. Sipas rekomandimit nr. 3330 date 20.03.2018 APP dhe nr. 145 prot date 16.03.2018 DPA i cili ka hyre ne fuqi me date 20.03.2018 ne lidhje me hartimin e kërkesave te cilësisë thekson rëndësinë qe ka akreditimi i dokumenteve/certifikatave te lëshuara nga organizmat e vlerësimit te konformitetit (labororë testues, kalibrues, organizëm certifikues i sistemeve te menaxhimit... etj.) te cilat janë te akredituara nga DPA ose nga organizma ndërkombëtar akreditues te njohur nga Republika e Shqipërisë. Si reference po ju dërgojmë praktiken online te akreditimit te laboratorit tone sipas udhëzimit te APP. Nisur nga rëndësia e objektit te prokurimit dhe qëllimit te përdorimit te produktit te prokuruar Autoriteti kontraktor nuk mund te anashkaloj një kërkesë te tille dhe duhet te ndjek te gjitha hapat për te marre informacion për verifikimin e vlefshmërisë dhe mbulimin e objektit te prokurimit ne fushën e testimit te laboratorëve përkatës. Përpos faktit qe test raportet duhet te jene lëshuar nga labororë te akredituar duhet qe akreditimi përkatës i tyre te jete i njohur edhe nga Republika e Shqipërisë ne baze te nenit 13, pika 3 e ligjit nr. 116/2014" Per akreditimin e organeve te vlerësimit te konformitetit ne Republikën e Shqipërisë " i ndryshuar . Mostrat e dorëzuara nga ana jone tek AK nuk i janë nënshtruar asnjë verifikimi te posaçëm e asnjë laborator vendas dhe jo me te huaj nga ana e AK dhe dyshimi i arsyeshem dhe bindja ekziston qe as për këto subjekte te kualifikuara nuk është kryer ky verifikim. Kërkojmë kryerjen e verifikimeve për çdo mostër te dorëzuar përpos mostrës tone dhe ato te OE te kualifikuara ose jo nga AK me qellim trajtimin e barabarte te OE. Mostrat janë kërkuar nga AK për vlerësim dhe jo për mbajtje produkti vitrine pasi ne te kundërt kjo kërkesë kthehet ne boomerang për AK. AK per sa kohe ka kërkuar mostrën dhe test raportet nënkupton Ex Ante se këto informacione do te verifikohen pra verifikim dokumentar dhe fizik. Por për këtë te fundit duhet te kërkojë verifikime ne labororë te specializuara. Nëse do te ecim me logjiken e heshtur te AK, nëse një OE sjell test raporte për karbon dhe mostër ka sjelle klor, atëherë ai është i privilegjuar për te dorëzuar klor bazuar ne kërkesat e posaçme te kontratave te furnizimit te parashikuara ne KC. Pra ne këtë supozim OE ka përdorur rezervën ligjore, ndaj AK është i detyruar te verifikojë mostrën dhe jo ta mbaj aty ne zyrat e tij për mall vitrine. Për me tepër ne piken 2.3.4 është kërkuar : Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi me objektin e prokurimit për mallin e kërkuar. Ne rast se do të paraqitet kjo e fundit duhet të vërtetohet

lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si. “ telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Rrjedhimisht në test raportin e paraqitur duhet të deklarohej origjina e lëndes kimike dhe prodhuesi në mënyrë që të krijohet lidhja dhe të vërtetohet se produkti i ofertuar është i prodhuar nga kompania nga e cila është marrë autorizimi dhe dokumentet e tjerë. Pra OE Ofertues nuk mund të testojë një produkt në laboratorët shqiptare apo të huaj në emër të shoqërisë së tij dhe ta paraqesë në tender si produkt të një kompanie X prodhuese sepse nuk vërtetohet që ajo mostër i përket atij prodhuesi. Fusha e veprimtarisë së Shoqërisë Trimed në QKB nuk përfshin objektin e prokurimit. Profili i shoqërisë përfshin fushën farmaceutike dhe mjekësore, në asnjë moment në objektin e QKR nuk përmendet fakti që kjo shoqëri ushtron aktivitet edhe në tregtimin e produkteve për trajtimin e ujit të pijshëm. Kjo dëshmon se perse oferta e këtij subjekti është e papërgjegjshme. Autoriteti Kontraktor në përgjigjen e tij jo vetëm nuk ka marrë parasysh asnjë nga arsyetimet e mesiperme por thekson faktin që shoqëria sene i bie barra e provës për të provuar pretendimet e ngritura, shoqëria jone pavaresisht faktit të theksuar prej AK kërkon nga KPP që sipas parashikimit të të njëjtes reference ligjore që ka perdorur AK të bëjë kontrollin e hollësisht të dokumentacionit i duhet të vihet në dispozicion nga AK ,pasi veprimet e AK për tu justifikuar me këto baze ligjore fshehin jo vetëm pabarazine në trajtimin e operatoreve pjesëmarrës por edhe diskriminim ndaj tyre. Gjithashtu AK ka anashkalluar faktin që ndodhemi përpara një procedure prokurimi ku për shkak të kërkesës për informacion konfidencial dhe arsye tregtare asnjë shoqëri nuk mund të njihet me dokumentat e paraqitura nga shoqëritë e tjera por kjo nuk i pengon operatorët që të ngrenë dyshime mbi plotësimin e dokumentave të caktuar të cilët për shkak të tregut ,vecantise dhe rëndësise se tyre janë vështirë për tu përvetësuar dhe plotësuar nga OE. Në si shoqëri ngrenë dyshime të arsyetuara në baze të studimit që kemi bërë në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar gjatë fazës së përgatitjes për pjesëmarrje në këto procedure dhe në baze të objektit(produktit,Karbon Aktiv Pluhur) mendojmë dhe jemi të bindur se OE-te e kualifikuar në këto procedure nuk i kanë paraqitur ose dhe në rast se i kanë paraqitur si emertime nuk i kanë paraqitur të plote dhe të sakte me të gjithë elementet e kërkuar në DST nga AK . Kërkojmë nga ju si autoriteti me i lartë në fushën e prokurimeve publike dhe me besimin e plote të drejtësisë dhe barazisë që ju aplikoni në shqyrtimin e dokumentave të paraqitur nga operatorët ekonomik në një procedure prokurimi verifikimin/kontrollin e detajuar dhe të sakte të të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria 2AT dhe TRIMED e sidomos të test raporteve(analizave) të Karbonit Aktiv Pluhur, laboratorët që e kanë testuar këtë produkt (Akreditimi dhe fusha e akreditimit) dhe të gjithë elementeve përberës të tij për shkak të rëndësise se perdorimit të këtij produkti nga AK, trajtimi i ujit të pijshëm për banorët e Tiranës. Mungesa, tejkalimi apo mosanalizimi i një elementi të caktuar mund të çojë në helmimin e shumë banoreve të cilët furnizohen me ujë nga ky autoritet. Kërkojmë një vlerësim të saktë, të drejtë dhe të barabartë midis të gjithë OE pjesëmarrësve në këto procedure qëndrim të cilin AK nuk e ka mbajtur duke favorizuar disa OE dhe diskriminuar disa të tjerë, Shoqëria jone me bindjen e plote që këto kërkesa nuk janë plotësuar nga Operatorët e sipërpermendur mban përgjegjësi të plote juridike dhe penale për pretendimet

e ngritura. Prandaj referuar sa me siper, ne rast se nuk do te respektonim kriteret e kualifikimit si shoqerite 2AT dhe TRIMED edhe oferta e shoqerise sone do te ishte e ndryshme (me e ulet) nga ajo e paraqitur duke hequr te gjitha kostot per plotesimin ekzakt te kerkesave te cilesise se produktit te kerkuara nga AK, ndaj nuk mundet qe AK ne kundershtrim me LPP te veproje me dy standarte ne kualifikimin e ofertuesve. Si perfundim bazuar ne argumentat, analizat dhe bazen ligjore te mesiperme kerkojme nga KPP kualifikimin e shoqerise sone per kete procedure, verifikimin e dokumentacionit te paraqitur nga Shoqerite 2AT dhe TRIMED shpk, konstatimin e fakteve te permendura nga shoqeria jone dhe skualifikimin e shoqerive 2AT dhe TRIMED shpk pasi jane kualifikuar padrejtesisht dhe nuk kane plotesuar kerkesat e kerkuara nga AK ne DST[...]

II.7.Në datën 20.04.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.K-1853/1prot., datë 19.04.2018, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimes,

Arsyeton:

III.1.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Power Industries" sh.p.k. për vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen : "[...Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik "POWER INDUSTRIES" sh.p.k me vlerë të ofertës 64.750.000(gjashtëdhjetë e katër milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh. • Së pari Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit kapaciteti teknik/ në pikën 2.3.2 si më poshtë cituar: Një punësim mesatar i të paktën 10(dhjetë) personave, për periudhën Qershor 2017 - Dhjetor 2017 të vërtetuar me; List pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Qershor 2017 - Dhjetor 2017 shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga verifikimi i dokumentave të operatorit ekonomik në sistemin elektronik të app-së konstatoi se shoqëria "POWER INDUSTRIES" shpk ka paraqitur në përmbushje të këtij kriteri listëpagesat për periudhën Qershor 2017 –Dhjetor 2017 por nuk ka arritur të paraqesë formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se dokumentacioni i shoqërisë lidhur me kriterin e mësipërm është i paplotë për rrjedhojë i pasaktë. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu

VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, I ndryshuar e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në pikën 2.3.2, të shtojcës 9, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon: “2.3.2Një punësim mesatar i të paktën 10(dhjetë) personave, për periudhën Qershor 2017 - Dhjetor 2017 të vërtetuar me; •Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Qershor 2017 - Dhjetor 2017; •List pagesat e punonjesve sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Qershor 2017 - Dhjetor 2017 shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.”

III.1.2. Për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Power Industries” sh.p.k ka dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vërtetim “Për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për pjesëmarrje në tender”, nr.436prot., datë 22.01.2018, lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve Tiranë.
- Deklaratat “Listëpagesat e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi” për periudhën Qershor 2017 – Dhjetor 2017.

III.1.3. Në nenin 46 pika 1 gërma “b” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 parashikohet se “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

III.1.4. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.1.5. Në nenin 28, pika 5 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, parashikohet se “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.1.6. Në nenin 65 pika 6 e Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008, “Për procedurat Tatimore”, i ndryshuar, i cili parashikohet se: “[...]Këshilli i Ministrave përcakton afatet kohore për dorëzimin e deklaratave tatimore e të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike.[...]”

Në VKM nr. 922, datë 29.12.2014 “Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumentave të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, neni 1, pika “xii” parashikohet se: “Dorëzimin e detyrueshëm, vetëm nëpërmjet formës elektronike, të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, objekt i këtij vendimi, me të cilat nënkuptohen: xii) deklarata “Listëpagesë e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi”.

Gjithashtu në Nenin 2 të VKM 922/2014 parashikohet se “Çdo tatimpagues është i detyruar të bëjë dorëzimin e deklaratave dhe dokumenteve tatimore, të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij vendimi, vetëm nëpërmjet formës elektronike, duke filluar nga data 1 janar 2015, sipas afateve ligjore të përcaktuara dhe formës së deklaratës apo të dokumentit të miratuar me udhëzim të ministrit të Financave.”

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron personelin e nevojshëm për realizimin e kontratës objekt shqyrtimi, gjë e cila vërtetohet nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, të lëshuar nga organet tatimore të cilat konfirmojmë se shoqëria “Power Industries” sh.a. ka një numër të konsiderueshëm punonjësish, si edhe nëpërmjet të të cilave jepet një informacion i detajuar që përmban të dhëna të mjaftueshme ashtu si dhe listëpagesat.

Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që nga dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik të vërtetohet se gëzon dhe disponon kapacitetet e duhura në lidhje me stafin dhe personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës, aq më tepër në kushtet kur ky dokumentacion është lëshuar nga organet

tatimore, në mbështetje të të dhënave të formularëve E-sig 025/a, për një periudhë që tregon qëndrueshmëri për këtë operator ekonomik, si edhe që përmban të dhëna të mjaftueshme për të arritur qëllimin për të cilin autoriteti kontraktor e ka kërkuar këtë kriter, duke siguruar një panoramë të plotë në lidhje me stafin dhe personelin e nevojshëm për realizimin e kontratës. Në këtë kuptim, edhe listëpagesat edhe vërtetimet e paraqitura nga organet tatimore për secilin punonjës që përmbajnë të dhëna të mjaftueshme për secilin prej tyre që janë deklaruar në mbështetje të të dhënave të formularëve E-sig 025/a për periudhën Qershor 2017 - Dhjetor 2017, janë dokumenta që i shërbejnë të njëjtit qëllim, vërtetimin që një shoqëri ka të punësuar pranë saj stafin e nevojshëm, ndaj në këtë rast sqarojmë se disponimi i personelit apo stafit të nevojshëm për realizimin e furnizimit të kërkuar, vërtetohet më së miri me dokumentacionin e paraqitur nga ky operator ekonomik, siç janë vërtetimet për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për individin. Në këtë kuptim KPP gjykon se operatorët ekonomikë nuk kanë detyrimin të tejkalojnë parashikimet ligjore në fuqi edhe kur një kusht i tillë vendoset në kriteret kualifikuese të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi sikundër në rastin konkret. Kriteret tilla në tejkallim të qëllimit për të cilat vendosen dhe në tejkallim të dispozitave ligjor nuk mund të shërbejnë si arsye për skualifikimin e operatorëve ekonomikë, aq më tepër në rastet kur informacioni e nevojshëm i kërkuar me anë të dokumentacionit të pa dorëzuar është lehtësisht i aksesueshëm dhe i verifikueshëm nga autoritetet kontraktore nëpërmjet sistemit elektronik përkatës.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik “Power Industries” sh.p.k me dokumentacionin e paraqitur vërteton se disponon kapacitete në lidhje me personelin sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2.Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Power Industries” sh.p.k. për vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “2AT” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin : “[...]1. Nuk ka paraqitur Test Raporte (flet analiza te produktit) me analizimin/testimin e te gjithe elementeve sipas kerkeses se AK, janë pranuar mallra pa test raporte, të paplota, tërësore dhe që nuk përputhen me raportin triangular cilësi, çmim, kohë dhe analiza me afate te tejkaluara. 2.Nuk ka paraqitur test raport (Flete analize te produktit) nga laboratore te Akredituar me ISO 17025. 3.Fusha e akreditimit te laboratorit sipas ISO 17025 duhet te perputhet me objektin e prokurimit qe te mundesoj analizimin e elementeve perberes te Karbonit Aktiv pluhur sipas kerkesave tuaja ne DST ,operatori ekonomik 2AT nuk e ka paraqitur . [...]” , Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1.Në pikën 2.3.2, paragrafi i tretë, të shtojcës 9, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon: “-Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë test raportet për lëndën Karbon Aktiv ku të jenë testuar parametrat e përcaktuar sipas standartit S SH EN

12903:2009. Test raportet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të originalit të leshuara nga laborator kombëtarë të akredituara ose laborator ndërkombëtare të akredituara, për të vertetuar sa më sipër kërkohej të paraqitet: 1.Certifikata e akreditimit të laboratorit 17025”

III.2.2.Në pikën 2 të shtojcës 10, “Specifikime teknike”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si vijon: “2 – Treguesit cilësor dhe të sigurisë së karbonit aktiv pluhur

Karboni aktiv pluhur që do të përdoret për trajtimin e ujit në Impiantin Bovillë duhet të jetë me origjinë bimore dhe aktivizimi i tij të jetë bërë me trajtim termik.

Treguesit e cilësisë dhe të sigurisë së karbonit aktiv pluhur që do të përdoret për trajtimin e ujit në Impiantin Bovillë duhet të përmbushin parametrat si më poshtë :

Nr	Parametrat	Njësia matjes	Specifikimet	Metoda
1	Densiteti dukshëm	Kg/m ³	200 - 750	EN12902/2004
2	Granulometria <150m	% në m/m	min. 95	EN12902/2004
3	Hiri	% në m/m	max. 15	EN12902/2004
4	Lagështia(ne ambalazhim)	% në m/m	max. 5	EN12902/2004
5	Nr Jodit	mg/g	min 900	EN12902/2004
6	Substancat e tretshme ne uje	% në m/m	max. 3	EN12902/2004
7	Zinku (Zn)	% në m/m	max. 0.002	EN12902/2004
8	Arseniku (As)	mg/kg	max.10	EN12902/2004
9	Kadmiumi (Cd)	mg/kg	max. 5	EN12902/2004
10	Krom (Cr)	mg/kg	max.50	EN12902/2004
11	Merkur (Hg)	mg/kg	max. 1	EN12902/2004
12	Nikel (Ni)	mg/kg	max.20	EN12902/2004
13	Plumb (Pb)	mg/kg	max.10	EN12902/2004
14	Antimoni (Sb)	mg/kg	max. 5	EN12902/2004
15	Selenium (Se)	mg/kg	max.10	EN12902/2004
16	Jone Cianur (CN ⁻)	mg/kg	max.50	EN12902/2004
17	PAH	mg/kg	max. 0.2	EN12902/2004

Parametrat e mësipërm janë në përputhje me Standartin Shqiptar S SH EN 12903 :2009 dhe S SH EN 12902:2004.”

III.2.2.Për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Power Industries” sh.p.k ka dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike dokumentacionin e mëposhtëm:

- Autorizim datë 13.02.2018, me anë të së cilës kompania “Jacobi Carbons” GmbH, autorizon vetë operatorin ekonomik “2AT” sh.p.k. që të marrë pjesë dhe të ofertojë me produktet (karbon aktiv pluhur) dhe dokumentat e saj në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar.
- Raport analizë datë 26.02.2018, për produktin “Karbon Pluhur Aktiv” të kompanisë “Jacobi Carbon” GmbH, e kryer nga laboratorit testues “WESSLING GmbH”, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar.
- Certifikatë akreditimi, lëshuar nga organizata akredituese DAKKS GmbH (Shoqëria Gjermane e Akreditimit), me anë të së cilës certifikohet laboratorit testues “WESSLING GmbH”, se është kompetente për të kryer të gjitha testimet laboratorike në fusha të ndryshme, konform DIN EN ISO/IEC 17025:2005, e përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar.
- Raport analizë datë 06.03.2018, për produktin “Karbon Pluhur Aktiv” të kompanisë “2AT” sh.p.k., e kryer nga laboratorit testues “SCA Laboratory Tests”.
- Certifikatë akreditimi, lëshuar nga Drejtoria e Akreditimit, me anë të së cilës certifikohet laboratorit testues shoqëria “SCA Laboratory Tests” sh.p.k për të kryer testimet laboratorike “Kërkesa të përgjithshme për kompetencën e laboratorëve testues dhe kalibrues”, konform S SH ISO/IEC 17025:2006.

II.2.3.Në nenin 46, pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “ [...] Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit[...].”

III.2.4. Në nenin 27 “Kontrata e Mallrave” pika 3 të VKM 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.5. Në nenin 27 “Kontrata e Mallrave” pika 6 gërma “c” të VKM 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që

tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.[...]”

III.2.6. Referuar natyrës së kriterit të kualifikimit të parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi si edhe nga interpretimi i nenit 46 pika 2 të LPP dhe nenit 27 pika 6 gërma “c” të të VKM 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për plotësimin e kriterit të mësipërm operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dëshmojnë me anë të dëshmive/testimeve zyrtare të lëshuar nga organe të pavarura të akredituara që vërtetojnë pajtueshmërinë e produktit të ofruar me standardet e kërkuara të cilësisë. Nga shqyrtimi i Raporteve të Analizave të paraqitura në mënyrë elektronike nga operatori ekonomik “2AT” sh.p.k., konstatohet se ato janë të lëshuara nga organizma të akredituara nga kompani akredituese apo Drejtoria e Akreditimit, për kryerjen e testimeve laboratorike, konform S SH ISO/IEC 17025:2006 apo DIN EN ISO/IEC 17025:2005, në përputhje me kërkesat autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi. Gjithashtu, nga shqyrtimi i këtyre dy raport-analizave, KPP vëren se është kryer testimi laboratorik me metodën EN 12902 për produktin “Karbon Pluhur Aktiv”, dhe janë pasqyruar parametrat e cilësisë për të gjithë elementët e kërkuar në shtojcën 10 “Specifikime teknike”, qoft në analizën e kryer nga kompania autorizuese, qoft në analizën e kryer nga operatori ekonomik “2AT” sh.p.k.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret synimi i autoritetit kontraktor është verifikimi i përpuethshmërisë së produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë me produktet e kërkuara nga autoriteti kontraktor (në specifikimet teknike). Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se me anë të dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ankimes ka vërtetuar përpuethshmërinë e produktit të ofruar me produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor (në specifikimet teknike).

Ndërsa lidhur, me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “[...]3.Fusha e akreditimit të laboratorit sipas ISO 17025 duhet të përputhet me objektin e prokurimit që të mundësojë analizimin e elementeve perberes të Karbonit Aktiv pluhur sipas kërkesave tuaja në DST, operatori ekonomik 2AT nuk e ka paraqitur[...]”, KPP vëren se, autoriteti kontraktor, në kriterin e vendosur në pikën 2.3.2, paragrafi i tretë, të shtojcës 9, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, nuk ka kërkuar në mënyrë eksplicite që akreditimi i laboratorit sipas ISO 17025 duhet të përputhet me specifikisht me objektin e prokurimit. Nga ana tjetër, nga verifikimet e kryera nga Komisioni i Prokurimit Publik, laboratorët të cilat kanë kryer testimin (WESSLING GmbH

dhe SCA Laboratory Tests), janë të akredituara në tërësi mbi analizimin dhe testimin të produkteve ku përfshihet edhe produkti objekt prokurimi. Në këto kushte, Komisioni sjell në vëmendje se, skualifikimi i operatorëve ekonomik pjesëmarrës, për një kriter të papërcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, do të binte ndesh me nenin 55, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet *2. Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.* Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se me dokumentacionin e dorëzuar, operatori ekonomik “2AT” sh.p.k., e ka përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.2, paragrafi i tretë, të shtojcës 9, “Kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Power Industries” sh.p.k. për vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “2AT” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin : “[...]Nuk është zhvilluar vlerësimi tërësor i mostrave të kërkuara, nuk është kryer testimi apo analiza të posaçme nga ana e AK për mostrat e paraqitura në ditën e hapjes së ofertave. Kërkojmë kryerjen e verifikimeve për çdo mostër të dorëzuar përpos mostrës tone dhe ato të OE të kualifikuar ose jo nga AK me qëllim trajtimin e barabartë[...]", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.K-1853/1prot., datë 19.04.2018, përkatësisht proces-verbali i vlerësimit të ofertave i mbajtur nga KVO, datë 30.03.2018, konstatohet se autoriteti kontraktor, mostrat e paraqitura, i ka vlerësuar në tërësi bashkë me kriteret e tjera të pranimit/kualifikimit. Nga ana tjetër, KPP vëren se operatorit ekonomik ankimues nuk ka paraqitur asnjë provë për të vërtetuar pretendimet e tij. KPP sqaron se barra e provës mbi pretendimet e sipërcituara bie mbi palën që inicion procedurën, në këtë rast mbi ankimuesin, në përputhje me parashikimet e nenit 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSh” ku përcaktohet se *“Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

Ndërsa lidhur me kërkesën për verifikimin e të gjitha mostrave, referuar VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshëm të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 17, “Forma dhe përmbajtja e ankesës”, pika 3:

- Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;”

III.3.2. Bazuar në sa mësipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimin e tij, ankimesi duhet të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicje dhe argumenta ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej ky pretendim. Vlen të ritheksojmë se, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 52 të LPP dhe nenit 64 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.3.3. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve ekonomikë të tjerë dhe jo të shpreh vetëm mosplotësimin e tyre në mënyrë të pargumentuar, si dhe të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e detyrimeve ligjore nga ana e autoritetit kontraktor. Një pretendim i ngritur në total, pa argumente të arsyeshme apo indicje të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementëve përbërës të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar përpara tij apo mbi veprimet apo mosveprimet e autoritetit kontraktor, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP. Komisioni i Prokurimit Publik është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë dhe refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimesit e të investohet mbi një pretendim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Power Industries” sh.p.k. ndaj vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Trimed” sh.p.k, në procedurën e prokurimit objekt shyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë, pasi operatori ekonomik “2AT” sh.p.k. përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. do të mbetet e kualifikuar, trajtimi i pretendimeve të ankimesit në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Trimed ” sh.p.k, nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në lëgjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimesit, nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt prokurimi, duke qënë se në renditjen përfundimtare, para tij qëndron një tjetër operator ekonomik i kualifikuar.

Në këto kushte, KPP gjykon që pretendimi i ankimesit nuk do të merret në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Power Industries” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Blerje karboni aktiv, për UKT sha*”, me nr. REF-43122-01-31-2018, me fond limit 69,000,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 12.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a.
2. Të anulohet vendimi e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Power Industries” sh.p.k. si dhe të korrigjohet shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 741 protokoli Datë 12.04.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha